



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:144112

Datë: 05.03.2021

Numri i dokumentit: 01571117

**PKR.nr.282/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupi gjykues Sami Sharaxhiu si dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët profesionist Sejdi Blakaj dhe Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lulavere Mala si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurve F. L. dhe D. L. që të dy nga ....., dhe atë për të pandehurin F. L. për vepër penale, vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, për vepër penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm , nga neni 356 par 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale, mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1. të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin D. L. , për vepër penale, sulm, nga neni 184 par.1. të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTHDKR në Pejë, PP/I.nr. 229/20 e datës 14.12.2020, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 04.03.2021 , në prezencën e Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit F. L. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit, av. G. K. nga Peja, të pandehurit D. L. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. D. K. nga Peja, të dëmtuarit M. A. nga Peja, të dëmtuarit T. Q. nga ....., mbrojtësi të viktimave nga ZMNV në Pejë D. H. , me datë 04.03.2021 muarr ,ndërsa me datë 05.03.2021, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**TË PANDEHURIT**

**F. L.** , i lindur me dt..... në ....., ku edhe a jeton rr. “.....” nr.83A, , i biri N. dhe U. gjinisë K., i martuar – baba i tre fëmijëve , me profesion instruktor në auto shkollën “.....”, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në paraburgim nga data 27.10.2020 e tutje.

**D. L.** , i lindur me dt. .... në .... ku edhe jeton rr. “.....”nr,85, i biri H. dhe R. e gjinisë O. , i pa martuar, ka të kryer shkollën mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i njohur sipas lnj. .... me nr. tel. .... dhe ....., Shqiptar, , shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.

**JANË FAJTORË**

**Për shkak se:**

## **I pandehuri F. L.**

**I.** Me dt.10.10.2020, rreth orës 12:15, në rr.”.....”, pranë Fakultetit të Biznesit në Pejë, me dashje, ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin M. A. nga fsh.....-K....., në atë mënyrë që ditën kritike në mëngjes, fillimisht i dëmtuari M. fjaloset verbalisht me të pandehurin F. dhe dëshmitarin N. L., në lokalit “.....” në ....., për shkak se i pandehuri F. e kishte shajt R. H. (te cilin i dëmtuari M. e ka dajë), ashtu që po të njëjtën ditë, deri sa dëshmitari N. ka qenë duke hy në veturën e auto shkollës afër fakultetit të biznesit, ndalohet nga i dëmtuari M., i cili e ndalon veturën e tij të tipit ..... krahas veturës së të dëmtuarit, del nga vetura për të biseduar me të, ashtu që në ato momente arrijnë i pandehuri F. dhe me të parë të dëmtuarin afër veturës së tij, nga brezi nxjerr revolen e tij të tipit TT, kalibër 7.62 mm, me numër serik C-208669, nga afërsia dhe nga prapa shtie tri herë në drejtim të dëmtuarit, ku me dy plumba kishte goditur atë në regjionin glutealo- perianal-femoral të dy anëve, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, të konstatuara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor me nr.Pe-45 e dt.22.11.2020.

- me çka ka kryer vepër penale, vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

**II.** Me dt.10.10.2020, rreth orës 12.15, në rrugën “.....”, pranë Fakultetit të Biznesit në Pejë, me përdorim të armës ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke vepruar siç është përshkruar në dispozitivin I, shtie tri herë me revole, ashtu që me një predhë e kishte goditur kalimtarin rastit – viktimën T. Q. nga ..... në këmbën e djathtë, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore në regjionin e shputës së këmbës së djathtë, lëndime këto të konstatuara si në akt ekspertimin mjeko ligjor me nr. Pe-45 të datës 22.11.2020.

- me çka ka kryer vepër penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 par.4 lidhur me par.1. të KPRK-së.

**III.** më parë e gjer me datë 10.10.2020, rreth orës 12:15, në rrugën “.....” pranë fakultetit të Biznesit në Pejë, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm me armët, ka mbajtur në pronësi armë dhe atë një pistoletë të llojit TT, kalibër 7.62 mm, ngjyrë e zezë, me numër serik C-208669, prodhim Jugosllav, e me të cilën armë ditën kritike ka tentuar ta privoi nga jeta të dëmtuarin M. A., e po ashtu ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e kalimtarëve të rastit, ku gjatë shtënies, me një predhë e kishte goditur edhe viktimën T. Q., duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore.

- me çka ka kryer vepër penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së,

## **I pandehuri D. L.**

Me datë 10.10.2020, rreth orës 12:15, në rrugën “.....”, pranë fakultetit të Biznesit në Pejë, ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit M. A., në atë mënyrë që ditën kritike pasi që i pandehuri D. e sheh të dëmtuarin afër dëshmitarit N. të cilin e ka djalë të axhës, i ofrohet të njëjtit dhe nga pas e godet në kokë me grusht dhe largohet nga vendi i ngjarjes.

- me çka ka kryer vepër penale, sulm , nga neni 184 par.1. të KPRK-së.

Andaj, gjykata, konform neni 2, 4, par.1. nënpar.1.1, dhe 1.3, neni 7, 8, 38 , 39 par.1. nën par.1.1 dhe 1.3, neni 40 par 1 nën par.1.2 dhe 1.3, neni 42, 43, 69, 71, 72, 76 par.1 dhe 2, nën par 2.2, neni 172 lidhur me neni 28 , neni 356 par.4 , lidhur me par. 1, neni 366 par.1. neni 366 par.3. si dhe neni 184 par.1. të KPRK-së, të pandehurit secili veç e veç i gjykon:

### **TË PANDEHURIN F. L.**

Për veprën penale nga pika I e dispozitivit të aktakuzës , gjykata e dënon me dënim me burg në kohëzgjatje prej **15 muajve** ( pesëmbëdhjetë muajve) .

Për vepër penale nga pika II e dispozitivit të aktakuzës , gjykata e dënon me dënim me burg në kohëzgjatje prej **10 muajve** (dhjetë muajve) .

Për vepër penale nga pika III e dispozitivit të aktakuzës , gjykata ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej **800 €** ( tetëqind euro) .

**Konform neni 76 par.1. dhe 2 nën par.2.2, të KPRK-së, gjykata të pandehurit F. L. i shqipton:**

### **DËNIM UNIK ME BURG**

Ashtu që ia përcakton dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej **1 ( një ) vit e 8 ( tetë ) muaj**, e në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.10.2020, e deri me datën 04.03.2021, e të cilin dënim unik me burg , i pandehuri do ta vuaj pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, si dhe

### **DËNIM E GJOBË**

Ashtu që ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej **800 € ( tetëqind euro)** e të cilin dënim me gjobë, i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej **30 ( tridhjetë ) ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e po që se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burg e ku një ditë burgu do të i llogaritet në shumë prej **20 ( njëzet ) euro**.

Konform neni 363 par.3. të KPRK-së , arma dhe atë një pistoletë e llojit “TT”, kalibër 7,62 mm, ngjyrë e zezë me numër serik C-208669, prodhim Jugosllav , si mjet me të cilin është kryer vepra penale, konfiskohet dhe urdhërohet që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e njëjta të shkatërrohet.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale , gjykatës të ia paguaj shumën prej **25 € ( njëzet e pesë ) euro** , në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor, gjykatës të ia paguaj shumën prej **25 € ( njëzet e pesë euro )**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **50 € ( pesëdhjetë euro )** , e të gjitha këto në afat prej 15 ( pesëmbëdhjetë ) ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform neni 367 par.1. nën par 1.2 të KPRK-së, të pandehurit F. L. , i ndërpritet paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit me datë 04.03.2021, dhe i njëjti lëshohet që të mbrohet në liri e gjer në plotfuqishmëri të aktgjykimit.

**TË PANDEHURIN D. L. gjykata e gjykon me :**

## DËNIM ME GJOBË

Ashtu që ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, e të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej **30 (tridhjetë) ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e po që se nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burg e ku një ditë burg i llogaritet në shumë prej **20 (njëzet) Euro**.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, gjykatës të ia paguaj shumën prej **25 €, (njëzet e pesë) euro**, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor, gjykatës të ia paguaj shumën prej **25 € (njëzet e pesë euro)**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **50 € (pesëdhjetë euro)**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

### *A r s y e t i m*

PTHDKR në Pejë, ndaj të pandehurve F. L. dhe D. L., ka ngritur aktakuzë dhe atë për të pandehurin F. L., për veprë penale, vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, për veprë penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 par 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1. të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin D. L., për veprë penale, sulm, nga neni 184 par.1. të KPRK-së, me propozim që të caktohet shqyrtim gjyqësor dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, të pandehurit të shpallen fajtor, të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa arma si mjet me të cilin është kryer vepra penale, të konfiskohet dhe të urdhërohet që e njëjta pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohet.

Të pandehurit F. L. dhe D. L., në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 04.03.2021, me rastin e leximit të aktakuzës, e kanë pranuar fajësinë për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohen, gjegjësisht i pandehuri F. L. për tri vepra penale ndërsa i pandehuri D. L. për një veprë penale, dhe këtë veprim e kanë bërë në baza vullnetare dhe të pa ndikuar nga askush si dhe pas konsultimit paraprak me mbrojtësit e tyre.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për secilin veç e veç ka deklaruar se meqenëse një pranim i tillë është i bazuar edhe në provat në bazë të cilave është ngritë aktakuza, i propozoi gjykatës që të aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Mbrojtësi i të pandehurit F., av. G. K. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ka deklaruar se pas bisedës me të mbrojturin tim dhe pasi që i njëjti i ka kuptuar të gjitha privilegjet dhe pasojat që dalin nga pranimi i fajësisë me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni nga kush do qoftë ka deklaruar se do ta pranoi fajësinë duke shprehur keqardhje andaj edhe trupit gjykues i propozoi që të pranohet një pranim i tillë nga ana e të mbrojturit tim si i vullnetshëm.

Mbrojtësi i të pandehurit D., av. D. K. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ka deklaruar se propozojmë që të pranohet pranimi i fajësisë, ky pranim i fajësisë është i

vullnetshëm dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si dhe në bazë të fakteve që përmban akuza .

I dëmtuari M. A. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve secilit veç e veç ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

I dëmtuari T. Q. lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve secili veç e veç .

Mbrojtësi i viktimave D. H. lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se meqenëse pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve secilit veç e veç është bërë në mënyrë vullnetare pa presion dhe pa ndikim edhe ne pajtohemi me pranimin e fajësisë ashtu që i propozoj ë gjykatës që ky pranim të pranohet.

Gjykata, pasi që të pandehurit secili veç e veç janë deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë dhe e kanë pranuar fajësinë, konform nenit 326 të KPPRK-së e ka aprovuar pranimin e fajësisë si të bazuar, ngase ky pranim është në harmoni edhe me nenin 248 par.1 të KPRK-së.

Meqenëse të pandehurit secili veç e veç e kanë pranuar fajësinë për veprë penale për të cilat akuzohen si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit F. L., ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale dhe atë të veprës penale, vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, të veprës penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm , nga neni 356 par 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe të veprës penale, mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1. të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin D. L. , elementet e ë veprës penale, sulm, nga neni 184 par.1. të KPRK-së, dhe njëherit para se gjykata të kaloj mbi marrjen e vendimit mbi dënim i ka ftuar palët në procedurë që të deklarohen në fjalë përfundimtare.

Prokurori i shtetit Valbona Disha Haxhosaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse të akuzuarit secili veç e veç sot pranuan fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar në bazë të aktakuzës, unë në tërësi mbes pranë aktakuzë, përshkrimit faktik dhe juridik të veprave penale, propozoi gjykatës që të njëjtët të i shpall fajtor, të i dënoj sipas ligjit si dhe të i obligoi në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale. Po ashtu i propozoi gjykatës që ndaj të akuzuarit F. L. të i shqiptoi edhe dënimin plotësues, konfiskimin e armës me të cilin janë kryer veprat penale. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim, i propozoi gjykatës që si rrethana lehtësuese për të dy të akuzuarit të vlerësoi pranimin e fajësisë kurse si rrethana rënduese të vlerësoi dënueshmërinë e të akuzuarit F. L. kurse për të akuzuarin D. nuk kemi rrethana rënduese .

I dëmtuari M. A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështesë fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit , njëherit do të paraqes kërkesën pasurore juridike në këtë çështje juridiko penale , njëherit edhe njëherë e konfirmoi se ne si familje në mes veti jemi pajtuar dhe nuk kemi më raporte të këqija.

I dëmtuari T. Q. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se unë do të parashtroj kërkesën pasurore juridike në këtë çështje juridiko penale , edhe njëherë e konfirmoi se me këtu të pandehurit, gjegjësisht me familjet e tyre jemi pajtuar dhe nuk kemi asgjë të keqe dhe tjetër nuk kam se çka të shtoi.

Mbrojtësi i viktimave D. H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve secili veç e veç, në tërësi u vërtetua se me sjelljet e të të njëjtëve ekzistojnë

elementet e veprave penale për të cilat pandehen, andaj edhe ne i propozojmë gjykatës që të njëjtit të i shpall fajtor dhe të i dënoi sipas ligjit, gjithashtu konform nenit 218 të KPPRK-së gjykatës ia dorëzojmë deklaratën mbi dëmin për të dëmtuarin M. A. si dhe njëherit nga një kopje ia dorëzon dhe mbrojtësve dhe prokurorit të shtetit .

Mbrojtësi i të pandehurit F. L. av. G. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi im F. L. që në shqyrtimin e parë fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale të armëmbajtjes, gjersa ne si mbrojtës në kërkesën për kundërshtimin e provave materiale dhe hedhjes së aktakuzës kemi paralajmëruar se në shqyrtimin kryesor do ta bëjmë pranimin e fajësisë edhe për veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm e që edhe asisoj ndodhi kështu që i mbrojturi im në shqyrtimin e sotëm me vullnet të plotë bëri pranimin e fajësisë për të gjitha veprat penale për të cilat ngarkohet me aktakuzë duke shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur ditën kritike dhe duke i kërkuar falje edhe njëherë të dëmtuarve, ashtu siç kishte bërë edhe në shqyrtimin fillestar andaj ashtu siç parashihet edhe me nenin 71 par.1 .2 dhe 1.3 të KPRK-së , ky pranim i vullnetshëm nga i mbrojturi im, nga ana e trupit gjykues të konsiderohet si rrethanë posaçërisht lehtësuese ashtu siç propozoi që si rrethana tjera lehtësuese nga ana e trupit gjykues të merret edhe marrëveshjet mbi pajtimet në mes të familjes L. dhe familjes A. dhe familjes Q. dhe se unë si mbrojtës edhe njëherë në emrin tim dhe në emër të familjes L. i falemi nderohemi shumë për një gjeste që është bërë në mes të këtyre familjeve që do të thotë gjesti i pajtimit, si rrethanë tjetër lehtësuese propozoi që të merret edhe fakti se i mbrojturi im është i martuar, është baba i tre fëmijëve të mitur , është i punësuar, është mbajtës së bashku me bashkëshorten i këtyre tre fëmijëve të mitur e sidomos të merret parasysh rrethana se i njëjti përpos që ka shprehur keqardhje shumë të madhe për atë çka ka ndodhur, i njëjti premtonte se në të ardhmen asnjëherë më nuk do të përsërisë çfarëdo qoftë vepër penale, ngase tani është i martuar do të kujdeset për fëmijët e tij të mitur dhe me sigurinë më të madhe nuk do të kryej më asnjë vepër tjetër penale , andaj duke i marrë parash të gjitha këto rrethana që i përmenda e të cilat janë rrethana posaçërisht lehtësuese, propozoi që duke u bazuar në nenet 71 dhe 72 të KPRK-së, ti keni parasysh të gjitha këto rrethana dhe të bëni zbutjen e dënimit dhe gjatë shqiptimit të dënimit të mbrojturit tim të i jepet dënim nën minimumin e paraparë ligjor me premtim se i njëjti asnjëherë më nuk do të ballafaqohet me ligjin , gjithashtu meqë i mbrojturi im gjendet në paraburgim nga data 27.10.2020 propozojmë që ndaj të njëjtit në këtë seancë të shqyrtimit kryesor të i ndërpritet paraburgimi.

I pandehuri F. L. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e përkrahu fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, më vjen keq për atë çka ka ndodhur, edhe njëherë kërkoi falje publikisht dhe premtoi se nuk do të përsërisë gjegjësisht nuk do të kryej më vepra tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurit D. L. , av. D. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi im sot në shqyrtim kryesor bëri pranimin e fajësisë dhe kërkoi nga gjykata që me rastin e vendosjes lidhur me vendimin mbi dënim këtë pranim të fajësisë ta merr si rrethanë posaçërisht lehtësuese , si rrethanë tjetër lehtësuese propozojmë që të merret mosha e re e të pandehurit , rrethanat e tij personale pasi që për një kohë të gjatë ka qenë i sëmur dhe vazhdon të mbetet në trajtim mjekësor për shkak të një paralize që ka pasur dhe ka qenë pandemia e cila e ka ndërprerë shërimin e tij jashtë vendit, si rrethanë tjetër lehtësuese propozojmë që të merret kërkim falje dhe pendimi i thellë, e të nderuar anëtar të trupit gjykues, meqenëse kemi të bëjmë me një vepër penal me të cilën parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal ti keni parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese pasi që edhe organi i akuzës sot për të pandehurin D. në fjalën përfundimtare nuk ceku asnjë

rrethane rënduese, për këto arsye kërkojmë që të mbrojturit tim të i shqiptohet një dënim me gjobë i cili dënim do të shërbej si preventivë speciale por edhe gjeneralë për të pandehurit tjerë, me premtimin e fuqishëm që kjo do të jetë hera e fundit që i njëjti do të ballafaqohet me ligjin .

I pandehuri D. L. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij njëherit kërkoj falje publike dhe premtoi se një gjë e tillë nuk do të ndodh më kurrë.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, për të pandehurit secilin veç e veç, konform nenit 69 dhe 71 të KPRK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurit Fisnik dhe Demokrat, gjykata mori për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve secilit veç e veç, pastaj pajtimin e arritur në mes të familjeve L., A. dhe Q., pastaj rrethanë lehtësuese për të pandehurit secilin veç e veç, gjykata mori për bazë kërkimin faljen e sinqertë drejtuar të dëmtuarve në shqyrtim gjyqësorë si dhe pendimin e shprehur, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin F. L., gjykata mori për bazë rrezikshmërinë shoqërore e cila ka mundur të shkaktohet në rastin konkret ku ka mundur të ketë edhe viktimë në njerëz e që fatmirësisht nuk ka, ndërsa për të pandehurin D. L. , gjykata nuk gjeti rrethana rënduese, andaj edhe të pandehurve, gjykata ia shqiptoi secilit veç e veç , dënimin sikurse në dispozitiv të aktakuzës, e bindur thellësisht se me këto dënime do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe të pandehurit secili veç e veç, do të parandalohen që në të ardhmen të kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Gjykata, konform nenit 366 par.1 të KPRK-së, të pandehurit F. L. , ia ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, me të cilin arma si mjet me të cilin është kryer vepra penale, është konfiskuar dhe është urdhëruar që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të shkatërrohet.

Gjykata , konform nenit 450 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, të pandehurit secilin veç e veç , i ka obliguar në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, si dhe konform ligjit nr.05/L-036, i ka obliguar edhe në paguarjen e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata, konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, i ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Gjykata, konform nenit 367 par.1 nën par.1.2 të KPPRK-së, të pandehurit F. L., ia ka ndërprerë paraburgimin pas shpalljes së aktgjykimit dhe të njëjtin e ka lëshuar që të mbrohet në liri , gjer në plotfuqishmëri të aktgjykimit.

Andaj, nga sa u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti për Krime të rënda, PKR.nr.282/20, datë 05.03.2021.**

Sekretarja juridike  
*Lulavere Mala*

Kryetari i trupit gjykues  
*Sami Sharaxhiu*

#### **UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit,

Numri i lëndës: 2020:144112  
Datë: 05.03.2021  
Numri i dokumentit: 01571117

Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë,  
e përmes kësaj gjykate.